**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**PKR.nr.249/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** sipas Kryetarit të Trupit Gjykues Kreshnik Radoniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale ndaj të penale kundër të pandehurve **K. P** nga Peja, **U. K.** nga fshati B, Republika e Sh, **E. A.** nga fshati S, Republika e Sh dhe **E.K.** nga fshati B, Republika e Sh, për shkak të veprës penale të kryer në grup *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për krime të rënda, PP.I.nr.310/16 të datës 18.11.2016 dhe Marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë me numër të njëjtë të datës 28.12.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 29.12.2016, në pranin e Prokurorit të Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit K. P., mbrojtësi të tij avokatit G. B., të pandehurit U. K., mbrojtësi i tij avokati H. Ç., të pandehurit E. A., mbrojtësit të tij avokat N. D., të pandehurit E.K. dhe mbrojtësit të tij avokat M.H., me datë 29.12.2016 murr dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë e përpiloj këtë:

**A K T GJ Y K I M**

Të pandehurit:

1. **K. P.** i lindur me datë .... në P, ku edhe banon në rr.”...” pa numër, i biri i S. dhe B. e lindur Gj., me numër personal ....., ka të kryer shkollën e ...., me profesion teknik i ....., i gjendjes së .... ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 02.11.2016 e tutje, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. **U. K.,** i lindur me datë ...., në T, me banim në fshatin B, Republika e Sh, i biri i Z. dhe M., e gjinisë P., me numër personal ....., ka të kryer shkollën ....., i gjendjes së ... ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje, Shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

3. **E. A.,** i lindur me datë ....., në T, me banim në fshatin S, Republika e Shqipërisë, i biri i A. dhe F., e gjinisë S., me numër personal ....., ka të kryer shkollën e ..., i gjendjes së ...

ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje, Shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

4. **E. K.,** i lindur me datë ...., në T, me banim në fshatin B, Republika e Shqipërisë, me numër personal ....., i biri i U. dhe N., e gjinisë P., ka të kryer shkollën ...., i gjendjes së ... ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje, Shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**JANË FAJTORË**

**Për shkak se:**

Me datë 28.10.2016, rreth orës 13:00, në J, të pandehurit duke vepruar në grup e me qëllim të shitjes kanë transportuar substanca narkotike të llojit marihuan nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake në mes të pandehurit K. me të pandehurit U. dhe E. K., i cili ky i fundit e fton të pandehurin E. që i njëjti ti ndihmojë në transportimin e një sasie të marihuanës nga Shqipëria për në Kosovë, duke joshur të njëjtin që për këtë punë do ta paguaj në shumën prej 100 eurove, ashtu që i pandehuri E. pasi pranon ofertën me datë 27.10.2016 në orët e mbrëmjes i pandehuri E. së bashku me dy personat e tjerë njëri nga Mali i Zi dhe tjetri nga Shqipëria, shkojnë në shtëpinë e të pandehurit E. dhe me veturën e tyre nisen për në fshatin Padesh- Shqipëri, dhe kur arrin në fshatin Padesh i pandehuri E. së bashku me të pandehurin E. kalojnë nëpër rrugë malore duke ecur 5-6 orë dhe duke i bartur dy thasë në shpindë me Marihuan dhe një çantë sportive deri në brendi të territorit të Kosovës ku dhe takohen me të pandehurin U. i cili ka qenë duke i pritur me xhip si dhe me të pandehurin K. i cili ka qenë me Pasat, ashtu që thasët me Marihuanë i vendosin ne Pasatin e K. ndërsa E. dhe E. hipin në xhipin e U, me ç'rast të pandehurit pasi që hetohen nga policia ndalohen dhe arrestohen në fshatin J, ku gjatë kontrollit dhe bastisjes policia i gjejnë dhe i sekuestrojnë substancë të dyshuar narkotike si e llojit Marihuanë në peshë të përgjithshme prej ..... gr.

- me çka duke vepruar si anëtar të grupit kanë kryer veprën penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42 par. 1 nën par. 1.1, 43 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, 45, 46, 73, 74, 75 dhe nenin 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, dhe nenit 233, 247, 248 par 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 367, 450 te KPPRK-se, të pandehurit i

**GJYKON**

1. **Të akuzuarin K. P.**

   Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **3 (tre) vite**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 02.11.2016 e tutje.

   Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **3.000,00 (tremijë) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari K. dështon që ta paguaj gjobën në afatin e përcaktuar si më lartë, dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqindepesëdhjetë) ditësh, duke llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I akuzuari K. obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale duke përfshirë edhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. **Të akuzuarin U. K.**

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **3 (tre) vite**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje.

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **3.000,00 (tremijë) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari U. dështon që ta paguaj gjobën në afatin e përcaktuar si më lartë, dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqindepesëdhjetë) ditësh, duke llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I akuzuari U. obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale duke përfshirë edhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3. **Të akuzuarin E. A.**

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje, dhe

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **1.700 (njëmijeshtatëqind) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari E. dështon që ta paguaj gjobën në afatin e përcaktuar si më lartë, dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 85 (tetëdhjetepesë) ditësh, duke llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I akuzuari E. obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale duke përfshirë edhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

4. **Të akuzuarin E. K.**

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **3 (tre) vite**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2016 e tutje, dhe

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **3.000,00 (tremijë) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari E. dështon që ta paguaj gjobën në afatin e përcaktuar si më lartë, dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqindepesëdhjetë) ditësh, duke llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I akuzuari E. obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale duke përfshirë edhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

* * *

Ndaj të akuzuarve **K. P**.dhe **U. K., E. A. dhe E. K** .në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, shqiptohet

**DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE/KONFISKIMI**

- vetura e tipit Passat Karavan me nr. te shasisë ....., 5 dyer, me targa ....., me ngjyrë të hirit dhe

- vetura e tipit Xhip Landrover Discovery, me nr. te shasisë ....., me ngjyrë jeshile, viti i prodhimit 1996, me targa të Republikës së Shqipërisë .....

- Substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej .....gr, të cilën substancë gjykata urdhëron që menjëherë të SHKATËRROHET.

e të gjitha këto sende të evidentuara me Dëftesën mbi konfiskimin e pronës të Policisë së Kosovës – Njësia DHTN Pejë, me numër të rastit 2016-DHTN-413 të datës 28.10.2016.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore - Departamenti për Krime të Renda në Pejë, ka ngrit aktakuzë, PP.I.nr.310/16 të datës 18.11.2016, kundër të pandehurve K. P. nga P, U. K. nga fshati B, Republika e Shqipërisë, E. A. nga fshati S, Republika e Shqipërisë dhe E. K. nga fshati B, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale të kryer në grup *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën fillestare për datën 07.12.2016, por gjatë kësaj seance mbrojta kërkoj shtyrjen e saj me qëllim që të tentohet të arrihet marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të pandehurve dhe prokurorit të shtetit.

Me datë 28.12.2016 prokurori i shtetit ka parashtruar marrëveshjet për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Pejë të përfaqësuar nga Prokurori Valbona Disha Haxhosaj, dhe të pandehurit K. P, U. K, E. A, dhe E. K, në prezencën e mbrojtësve të tyre.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 29.12.2016 në pranin e prokurorit të Shtetit, të pandehurve K. P, mbrojtësit të tij avokatit G. B. (me autorizim zëvendësues, ndërsa avokati G. K. është paraqitur gjatë zhvillimit të seancës), U. K, mbrojtësit të tij avokatit H. Ç., E. A., mbrojtësit të tij avokatit N. D., të pandehurit E. K. dhe mbrojtësit të tij avokatit M. H.

Gjatë seancës fillestare u shqyrtuan marrëveshjet për pranimin e fajësisë. Sipas marrëveshjes, të pandehurit K., U. dhe E., janë pajtuar që për veprën penale për të cilën akuzohen t'i shqiptohet një dënim prej me burg prej 2 vite e 9 muaj deri në 3 vite e 6 muaj, dhe dënimi me gjobë prej 2.700 euro deri në 3000 euro, ndërsa për të pandehurin E. A. dënimi që kanë lidh marrëveshje është prej 2 vite e 6 muaj deri në 3 vite dhe dënimi me gjobë prej 1700 euro deri në 2000 euro. Po ashtu të pandehurit janë pajtuar që të heqin dorë nga parashtrimi i ankesës ndaj aktgjykimit, të cilën e konfirmuan edhe gjatë seancës fillestare.

Gjatë kësaj seance gjykata është bindur se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, dhe se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar apo të shtrënguar në asnjë mënyrë të pranojnë fajin. Pranimi i fajësisë mbështetët në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hudhjen e aktakuzës që parashihet me nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Pas bindjes së gjykatës për të lartcekurat, dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit dhe të mbrojtësve të pandehurve lidhur me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, Gjykata konstatoj se të pandehurit pranuan fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPPRK-se janë përmbushur, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas aprovimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të të pandehurve K. P., U. K., E. A. dhe E. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të kryer në grup *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të pandehurit e kanë kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin E. A. dhe E. K. gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtit më parë kishin pasur sjellje

korrekte dhe nuk kishin rënë asnjëherë në konflikt me ligjin, për të pandehurin E gjykata si rrethanë lehtësuese morri edhe faktin se i njëjti ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë që në fazën më të hershme të hetimeve. Si rrethana lehtësuese për të katër të pandehurit, gjykata mori parasysh gjendjen e tyre të vështirë ekonomike dhe sjelljen e tyre korrekte gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, si dhe pendimin e thellë të tyre, duke i premtuar Gjykatës se në të ardhmen një gjë te tillë më nuk do ta përsërisin, rrethana të cilat kjo Gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese për ta. Si rrethanë tjetër lehtësuese, për të pandehurit Gjykata murr për bazë marrëveshjen mbi pranim e fajësisë e lidhur në mes të pandehurve dhe prokurorit të shtetit ku të pandehurit kanë pranuar fajësinë për veprën penale që iu vihet në barrë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjë që dëshmoi gatishmëri për bashkëpunim me organet e rendit dhe kjo sipas vlerësimit të Gjykatës paraqet pendim të sinqertë dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tyre.

Si rrethana rënduese për të akuzuarit gjykata gjen masën e madhe të narkotikëve e cila është sekuestruar pasi që të akuzuarit janë zënë duke e kryer veprën penale për të cilën kanë pranuar fajin. Gjithashtu për të pandehurin K. P. gjykata gjen se i njëjti ka qenë i dënuar më parë nga Gjykata Themelore në Pejë për vepër penale falsifikim i veturave me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, edhe për të pandehurin U. K. gjykata gjen se ka qenë i dënuar më parë nga ana e gjykatës së Republikës së Shqipërisë për vepër penale armëmbajtje pa leje me dënim burgu prej 8 muaj të cilat i ka vuajtur. Këto rrethana janë të vërtetuara nga vet të pandehurit gjatë seancës fillestare.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 73 të KPRK-së të pandehurit K., U. dhe E. i gjykoi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Ndërsa për të pandehurin E gjykata ka zbatuar zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit sipas nenit 75 i KPRK-së dhe ka ulë dënimin nën minimumin ligjor, duke vlerësuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, bashkëpunimin me organet e rendit, gjendjen e tij të vështirë ekonomike dhe faktin se asnjëherë nuk ka qenë i dënuar më parë nga ana e gjykatës, si rrethana posaçërisht lehtësuese, e me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 te KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale duke përfshirë edhe paushallin gjyqësor për secilin të pandehur veç e veç në shumë prej 100 (njëqind) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Ndaj të pandehurve në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i dy veturave të cilat janë përdorur në kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpall fajtor të pandehurit, si dhe substancës narkotike të llojit marihuar në peshë ... kilogram dhe ... gram, si substancë që i nënshtrohet konfiskimit të detyrueshëm nga neni 273 par. 4 të KPRK-së, dhe duke aplikuar nenin 282 par. 2 nën par. 2.4 dhe par. 3 të KPPRK-së urdhërohet shkatërrimi i kësaj substance narkotike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**
**PKR.nr.146/16 më datë 29.12.2016**

| | |
|---|---|
| **Sekretarja Juridike** | **Kryetari i Trupit Gjykues** |
| **_____** | **_____** |
| **Gjyljeta Çorkadiu** | **Kreshnik Radoniqi** |

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.